



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 03.11.2025

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 29.10.2025.

Në vijim të kërkesës suaj të datës **29.10.2025**, ardhur me postë elektronike, me objekt “*Kërkesë për informacion*” pranë Bashkisë Himarë, ju informojmë si më poshtë:

1. A ka Bashkia Himarë një Plan Social të miratuar dhe nëse po, kur është miratuar?

Po, Plani Social i Bashkisë Himarë është miratuar me vendimin nr. 39, datë 31.07.2025.

2. Sa projekte ka zbatuar apo po zbaton Bashkia Himarë nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social për periudhën 2023–2025?

Plan social për vitin 2023-2025 nuk ka bashkia dhe për rrjedhojë ska aplikime për Fond Social.

3. Sa përqind të fondit të përfituar keni përdorur deri tani, të ndarë sipas viteve 2023, 2024 dhe 2025?

Deri më tani **nuk janë përdorur fonde**, pasi Bashkia nuk ka përfituar nga ky mekanizëm.

4. A ka aplikuar Bashkia Himarë për të përfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues në vitin 2025?

Po, Bashkia Himarë ka aplikuar, por ende **nuk janë shpallur fituesit**.

5. Sa ka qenë vlera totale e miratuar nga MSHMS dhe e disbursuar për vitin 2025, dhe për cilat kategori shërbimesh janë përdorur?

0 (zero), pasi ende **nuk ka pasur aplikim të miratuar apo disbursim fondesh** për këtë vit.

6. A keni parashikuar në buxhetin afatmesëm 2026–2028 fonde për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor, si kontribut i Bashkisë, edhe pas përfundimit të financimit nga Fondi Social?

Po, në përputhje me udhëzimet përkatëse, parashikohet bashkëfinancim sipas skemës:

- o Viti i parë: 10% Bashkia – 90% Ministria

- o Viti i dytë: 40% Bashkia – 60% Ministria
- o Viti i tretë: 70% Bashkia – 30% Ministria

7. Cilat janë kategoritë e shtresave vulnerabël të identifikuara në Bashkinë tuaj që përfitojnë aktualisht nga shërbimet sociale të ofruara nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social?

Kategoritë që përfitojnë janë:

- o persona me aftësi të kufizuar,
- o gra të dhunuara,
- o të moshuar të vetmuar.

Faleminderit mirëkuptimin.